



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

Website: www.gjykata.gov.al

Adresa: Lagjja "5 Maji", Rruga "Koço Brisku", Elbasan, Shqipëri.

PRGRAMI TRANSPARENCËS

ANEKS B. Indeks- Lidhja (7)

PAKETA LIGJORE

Aktualisht jemi në fazën ku Shqipëria po zbaton një reformë të thellë të sistemit të drejtësisë duke u kujdesur që legjislacioni të jetë koherent e që institucionet e sistemit të drejtësisë të punojnë me performancë të lartë, të ketë një ndarje të pushteteve dhe të gjithë të trajtohen në mënyrë të drejtë e të barabartë përpara ligjit. Reforma kushtetuese dhe legjislative gjithëpërfshirëse u hartua me qëllim forcimin e integritetit dhe qeverisjes së gjyqësorit në vend.

"Misioni i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan udhëhiqet nga dëshira për të ndërtuar një gjykatë me performancë të lartë, që synon dhënien e drejtësisë dhe arritjen e besimit të plotë të publikut. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan zotohet se do të trajtojë të gjithë qytetarët si të barabartë përpara ligjit duke zbatuar një nga të drejtat dhe liritë themelore të individit të parashikuara dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në nenin 18-të të saj¹. Gjykata garanton se, e gjithë Trupa Gjyqësore dhe nëpunësit civilë gjyqësorë janë të gatshëm të marrin përgjegjësi të plotë për veprimet e tyre. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, zotohet të funksionojë si një organ i pavarur, i pandikuar nga ndërhyrjet dhe i angazhuar ndaj sundimit të ligjit, do të veprojë në përputhje me parimet më të larta morale dhe etike dhe që gjithmonë do të bëjë drejtësi. Gjyqtarët e kësaj gjykate zotërojnë të gjitha aftësitë e nevojshme për të përmbushur më së miri rolin e tyre në proklamimin dhe dhënien e drejtësisë."


Struktura e pushtetit gjyqësor në Shqipëri përcaktohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Veç gjykatave të krijuara për gjykime të juridiksionit të përgjithshëm, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon edhe krijimin e gjykatave të posaçme të cilat gjithashtu janë të ndara në gjykata të shkallës së parë dhe gjykata apeli. Këto ndarje përbëjnë dhe 3 (tre) shkallët e gjyqësorit.

1. Gjykatat e Shkallës së Parë.
2. Gjykatat e Apelit.

¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë-Neni 18. 1. "Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit"

3. Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë.

Në gusht 2016, Amendamenti Kushtetues i hapi rrugë Reformës në Drejtësi. Risi e Hartës së Re Gjyqësore është krijimi i Gjykatave të Posaçme. Harta Gjyqësore e Re krijon një ndarje të tillë të Gjyqësorit në Republikën e Shqipërisë si në figurën poshtëvijuese.



(Fig.1. burimi nga faqja zyrtare e www.gjykata.gov.al)

2

Si edhe vërehet përbërja e Hartës së Re Gjyqësore përfshin:

- Gjykata të Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm (13) - tembëdhjetë;
- Gjykata të Shkallës së Parë Administrative (2)- dy;
- Gjykata Administrative Apeli ,(1) një;
- Gjykatë e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm (1) një;
- Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (1) një;
- Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (1) një;
- Gjykata e Lartë (1) një;

Në këtë faqe interneti www.gjykata.gov.al , në aneksin e dedikuar për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, kjo gjykatë vendos në dispozicion të publikut materiale informuese

² <https://gjykata.gov.al/>

mbi veprimtarinë e gjykatës sipas rubrikave përkatëse, gjithashtu në këtë faqe interneti në një rubrikë të veçantë është vendosur edhe Programi i Transparencës.

Ndryshimet kushtetuese të Amendamenti Kushtetues i vitit 2016, u pasuan me miratimin e një pakete ligjore, e cila solli ndryshime thelbësore në organizimin dhe funksionimin e organeve të sistemit të drejtësisë. Ndryshimet kushtetuese hynë në fuqi në datën 12 gusht 2016. Menjëherë pas miratimit të këtij ligji themelor, u vijua me miratimin e një pakete të tërë ligjesh mjaft të rëndësishme në stadin e parë të zbatimit të ndryshimeve kushtetuese dhe të implementimit të Reformës në Drejtësi.

Konkretisht, në këtë faqe interneti, do të mund të njiheni dhe të konsultoni disa nga ligjet më të spikatura të kësaj reforme, si edhe:- akte normative, vendime dhe udhëzime të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që Autoriteti Publik këtu (Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan) zbaton dhe aplikon në funksion të organizimit, rekrutimit dhe funksionimit të organikës, në funksion të zbatimit të drejtës së informimit³ si garanci për garantimin e të drejtave themelore të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe përpunimit të të dhënave personale dhe sensitive në kuadër zbatimit të ligjit në fuqi 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Legjislacioni, aktet dhe udhëzimet si më poshtë vijon:

- *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Ndryshuar me ligjin nr.9675, datë 13.1.2007; nr.9904, datë 21.4.2008; nr.88/2012, datë 18.9.2012, nr.137/2015, datë17.12.2015 dhe nr.76/2016, datë 22.7.2016).*
- *Ligj Nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”(ndryshuar me ligj nr. 46/2021, date 23.03.2021);*
- *Ligj Nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”(Shfuqizuar nene me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.4.2017, ndryshuar me ligjin nr.48/2019, datë 18.7.2019, nr. 15/2020, datë 12.2.2020; nr. 149/2020, datë 17.12.2020; nr. 50/2021, datë 23.3.2021; nr. 33/2023, datë 25.5.2023) (i përditësuar);*
- *Ligj Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” (shfuqizuar nene me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 41, datë 16.5.2017 dhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 78, datë 12.12.2017, ndryshuar me ligjin nr. 47/2019, datë 18.7.2019) (i përditësuar);*
- *Ligj Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (I ndryshuar me ligjin nr.78, datë 21.09.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”) (i përditësuar);*
- *Ligj Nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;*
- *Vendim Nr. 149, datë 29.03.2023 “Për Miratimin E Rregullave Standarde Për Organigramën, Përshkrimin E Detyrave Dhe Përgjegjësiave Të Pozicioneve Të Nëpunësve Civilë Gjyqësorë Dhe Punonjësve Të Tjerë Të Gjykatave Të Shkallës Së Parë Të Juridiksionit Të Përgjithshëm, Kategoria E Dytë Dhe E Tretë, Pa Zyra Shërbimi”;*
- *Vendim Nr. 716, Datë 06.12.2023 “Për Miratimin e Udhëzuesit Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median.”;*
- *Udhëzim Nr. 85, datë 11.03.2021 “ Procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurrimit të hapur”i Këshillit të Lartë Gjyqësor;*

³Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë- Neni 23. 1. “E drejta e informimit është e garantuar.”

- Vendim Nr. 554, datë 29.12.2022 "Për Ndarjen me Short të Çështjeve Gjyqësore" i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Vendim Nr. 622, datë 10.12.2020 "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor" i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- Vendim Nr. 171, datë 22.04.2021 "Për Miratimin e "Kodi i Etikës Gjyqësore" të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- Vendim Nr. 71, datë 20.05.2019 "Për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës" i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Ligj Nr. 44/20151 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
- Ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësit civil", i ndryshuar;
- Ligj Nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik"

Kjo paketë ligjore përfshin disa nga disa nga ligjet më të spikatura të kësaj reforme, akte normative, vendime dhe udhëzime të Këshillit të Lartë Gjyqësor por nuk është shteruese.

Kjo paketë ligjore është një proces i hapur dhe në përditësim të vazhdueshëm sa here do të shihet e nevojshme të ketë një përditësim.

Faleminderit,

Miratoi

ZV/KRYETAR
Z. ELIS DINE

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

